



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 66, datë 14.07.2020

PËR

VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 6 PALLATEVE TË NDODHURA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.1, NJËSITË ADMINISTRATIVE SUKTH, KATUND I RI DHE TË 1 (NJË) BANESE INDIVIDUALE TË NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, DURRËS, TË GJITHA PRONË PRIVATE, NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 6 (gjashtë) pallateve të ndodhura në Njësinë Administrative nr.1, Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri dhe të 1 (një) banese individuale të ndodhur në Njësinë Administrative nr.5, Durrës, të gjitha pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë sipas listës bashkëngjitur.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 14.07.2020

	PROT/DATE	OBJEKTE	Nr. KATI	KATEGORIA	ADRESA	G.I.S/ KORDINATA	INVESTITOR
1	4737 07.05.2020 Nr.prot.Instituti:976 07.05.2020	Shtepi Individuale	4 kat	BANESE	Rr: "Luigj Gurakuqi", Lagjia 14, Durrës		Sadik Kllogjeri
2	Prot.8907 Data: 10.07.2020 Nr.prot.Inst:1575/1	Pallati Nr.24	5 kate	PALLAT	Njesia Administrative Sukth	41.36513 19.54819	Shteti
3	Prot.8687 Data: 08.07.2020 Nr.prot.Inst:1576	Pallati Nr.31	5 kate	PALLAT	Katund i Ri	41.39126 , 19.47755	Shteti
4	Prot.8687 Data: 08.07.2020 Nr.prot.Inst:1576	Pallati Nr.29	5 kate	PALLAT	Katund i Ri	41.39123 , 19.47759	Shteti
5	Prot.8687 Data: 08.07.2020 Nr.prot.Inst:1576	Pallati Nr.27	5 kate	PALLAT	Katund i Ri	41.36513 , 19.54819	Shteti
6	Prot.8687 Data: 08.07.2020 Nr.prot.Inst:1576	Pallati Nr.22	5 kate	PALLAT	Sukth	41.35240 , 19.55023	Shteti
7	Prot.8532 Data: 6.07.2020 Nr.prot.Inst:1581	Ndertesa Nr.1	6 kate	PALLAT	Rruga "Milosao"	41.318386 19.443913	



Nr. 9067/2 Prot , date 15.07.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 628 / prot.

Durrës, më 15.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 66 datë 14.07.2020 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 6 pallateve të ndodhura në Njësinë Administrative Nr 1, Nj.Adm Sukth, Katund i Ri dhe të një banese individuale të ndodhur në Njësinë Administrative Nr 5, Durrës, të gjitha pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë ”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

